ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **207-24-9503-2-2-3**

Nr i brendshëm: **207-24-086-2-2-3**

Sa i përket tenderit për : **Zhvillimi i projektit ideor dhe të hollësishëm [zbatues kryesor], të arkitekturës dhe të inxhinierisë, për ndërtimin e Stadiumit të ri në Rahovec, në përputhje me Kategorinë II plus të rregulloreve dhe udhëzimeve teknike për infrastrukturë të stadiumeve, të miratuara nga UEFA. RITENDERIM**

ANKESË

"INFRA PLUS" SH.P.K
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Prishtinë – Ferizaj Km 5, Llapllasellë - Graçanicë *(Adresa)*

Graçanicë **10 500**
(Vendi) *(Kodi postar)*

038 60 62 62
(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

MUSA ISLAMAJ
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@infraplus-ks.com
(Adresa elektronike)

17/04/2025
(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Në bazë te tenderit te publikuar **Zhvillimi i projektit ideor dhe të hollësishëm [zbatues kryesor], të arkitekturës dhe të inxhinierisë, për ndërtimin e Stadiumit të ri në Rahovec, në përputhje me Kategorinë II plus të rregulloreve dhe udhëzimeve teknike për infrastrukturë të stadiumeve, të miratuara nga UEFA. RITENDERIM** me NRP: **207-24-9503-2-2-3**, ne afatin e rregullt kohor parashtrojmë ankesë ne OSHP:

12.09.2024 – Njoftim për Konkursin e Projektimit
15.10.2024 – Afati për dorëzimin e ofertave/kërkesës për pjesëmarrje
01.04.2025 – Njoftimi mbi vendimin e AK - Njoftimi final
07.04.2025 – Kërkesa për Rishqyrtim
10.04.2025 – Vendim mbi refuzimin e kërkesës për Ri-shqyrtim
17.04.2025 – Ankesa ne OSHP

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒ **X**

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] **Jo** [ ]

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se. 07.04.2025 – Kërkesa për Rishqyrtim 10.04.2025 – Vendim mbi refuzimin e kërkesës për Ri-shqyrtim

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK me rastin e zbatimit te aktiviteti te prokurimit me titull: **Zhvillimi i projektit ideor dhe të hollësishëm [zbatues kryesor], të arkitekturës dhe të inxhinierisë, për ndërtimin e Stadiumit të ri në Rahovec, në përputhje me Kategorinë II plus të rregulloreve dhe udhëzimeve teknike për infrastrukturë të stadiumeve, të miratuara nga UEFA. RITENDERIM** me NRP: **207-24-9503-2-2-3** nuk ka respektuar dispozitat Ligjit për Prokurim Publik nr. Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068, Nr. 05/L-092, dhe Udhëzuesin Operative dhe Rregulloret e Prokurimit si ne vijim: Nenin 1 te LPP-se Nenin 7 të LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi Nenin 52 te LPP_se Nenin 55 te LPP_se Nenin 59 te LPP_se Neni 25 te RRPP 002/2024 Neni 25 të LPP-së Neni 40 te RRPP 002/2024 Neni 10 i UOPP 001/2023

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Sipas **Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje ligjore** :

Pretendimi 1:

Pretendimi i parë ka të bëjë me Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare qe sipas FDT është kërkuar:

Kërkesa 1.1 - Operatori ekonomik Grupi i operatoreve ekonomik, duhet të ofrojë dëshmi të kompetencës dhe përvojës së mjaftueshme për të zbatuar në mënyrë efektive kontrata [gjithnjë në mënyrë të rregullt ligjshme] për shërbime projektimi. Për këtë qëllim, Operatori ekonomik Grupi i operatoreve ekonomik, duhet të dëshmojë se gjatë tre [3] viteve fiskale të shkuara- 2021, 2022 dhe 2023, ka zbatuar kontrata për zhvillimin e projekteve ideore dhe të hollësishme, të arkitekturës dhe të inxhinierisë, për zhvillimin e ndërtesave publike shoqërore, shuma e grumbulluar e të cilave duhet të tejkaloj 150,000.00 € [një-pesë-zero, zero-zero-zero, zero-zero euro].

Dëshmia e kërkuar dokumentare- Kërkesa 1.1.1. - Operatori ekonomik Grupi i operatoreve ekonomik, duhet të dorëzoj [i] Kontratat dhe Raportet e pranimit të projekteve shërbimeve, të lëshuara nga Autoritetet kontraktuese publike private OSE [ii] Certifikatat ose Referencat e përfundimit me cilësi të lartë, të projekteve shërbimeve, të lëshuara nga Autoritetet kontraktuese publike private - Një [1] kopje e origjinalit, e vërtetuar nga noteri, për secilën dëshmi dokumentare. Dëshmia e kërkuar dokumentare- Kërkesa 1.1.2 -Për secilën nga kontratat e deklaruara, ne kornize te 'Dëshmia e kërkuar dokumentare- Kërkesa 1.1.1.', Operatori ekonomik Grupi i operatoreve ekonomik, duhet të plotësoj 'Tabelën 1', nëpërmjet paraqitjes së të dhënave tekstuale dhe numerike, si dhe të fotografive, në katër [4] faqe [bashkërisht me tabelën në fjale] me madhësi A4 - Një [1] kopje e tabelës 1, e plotësuar, e kompletuar dhe e dorëzuar sipas kërkesës, veçantë për secilën kontrate te deklaruar. Shënim me rendësi- Kërkesa 1.1. - Ndërtesat publike shoqërore, në rastin e kësaj lënde aktiviteti të prokurimit, nënkupton dhe përfshinë të gjitha tipologjitë e ndërtesave të sportit, të kulturës, të arsimit, të shëndetësisë, të administratës [nën-administrim pronësi shtetërore- lokale qendrore (brenda dhe jashtë Kosovës), nën-administrim pronësi të shteteve të tjera ose të organizatave ndërkombëtare (brenda dhe jashtë Kosovës)], ndërsa përjashton të gjitha tipologjitë e ndërtesave të shërbimeve dhe tregtare [nën-administrim pronësi private]; të gjitha tipologjitë e ndërtesave të banimit shumë-katesh, si të veçanta apo të kombinuara me çfarëdo përmbajtje të tjera funksionale [nën-administrim pronësi private] dhe të gjitha tipologjitë e ndërtesave të industrisë dhe të magazinimit; dhe të gjitha tipologjitë e infrastrukturës së transportit dhe teknike dhe të tjerave të ngjashme [duke mos pasur parasysh formën e administrimit pronësisë], si të veçanta apo të kombinuara me çfarëdo përmbajtje të tjera hapësinore funksionale.

AK, në përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim, e ka arsyetuar vendimin e tyre duke iu referuar ne mënyrë te gabuar nenit 65, paragrafi 3 të LPP-së qe ka te beje me P**rovueshmëria e**

Kandidatëve ose Tenderuesve, dhe se ka të drejtë të vlerësojë nëse OE i përmbush kërkesat e kualifikimit, duke përfshirë përvojat. Për më tepër, AK i referohet një udhëzuesi nr. 01/2017, i cili nuk është në fuqi apo nuk gjendet fare në listën e Udhëzimeve të KRPP-së, për të mbështetur vlerësimin e tij dhe në këtë mënyrë duke e përdorur si bazë juridike për të justifikuar vendimin e kundërligjshëm.

Sikurse është përshkruar më lart, AK, në kundërshtim me kriteret që vetë i ka vendosur në FDT, tani i konsideron se ka të drejtë të zgjedhë se cili dokumentacion është i pranueshëm për AK-në. Për më tepër, i referohet neneve që nuk kanë të bëjnë fare me atë që kontestohet këtu, si dhe udhëzimeve të panjohura apo të shfuqizuara.
Ju rikujtojmë se kriteret e FDT-së janë të detyrueshme për të gjithë OE-të dhe gjatë vlerësimit duhet të trajtohen në përputhje me nenin 40.6 të Rregullores për Prokurim Publik (RRPP), dhe jo të vendosen bazuar në udhëzime, te drejta pa mbështetje ligjore apo nene që nuk janë të zbatueshme për këtë rast.
Përkundër faktit se AK në këtë fazë i referohet kritereve si "shërbime të ngjashme", në kërkesat e FDT-së është kërkuar në mënyrë të qartë dhe të prerë, citoj: "**për zhvillimin e projekteve ideore dhe të hollësishme, të arkitekturës dhe të inxhinierisë, për zhvillimin e ndërtesave publike shoqërore"** të cilat OE i rekomanduar për kontratë nuk i plotëson.

OE i rekomanduar për kontrate ka dorëzuar gjashte (6) referenca si me poshtë:

- Shërbime projektuese te instalimeve ne shkollën Dëshmorët e Qëndresës – Gllareve –Kline

Ky projekt sipas referencës ka te beje vetëm me fazën e instalimeve e cila nuk përputhët me kërkesën e FDT "**për zhvillimin e projekteve ideore dhe të hollësishme, të arkitekturës dhe të inxhinierisë,"** prandaj si reference nuk e plotëson kërkesën e AK-se dhe si e tille nuk duhet te pranohet sepse nuk është projekt i kompletuar i objektit duke përfshirë fazën e arkitekturës dhe inxhinierisë mirëpo siç ceket edhe ne reference është vetëm për fazën e instalimeve çka nuk është ne përputhje me vete kërkesat e FDT-se.

- Shërbime projektuese te instalimeve ne shkollën Shaban Shala - Podujevë

Ky projekt sipas referencës ka te bëjë vetëm me fazën e instalimeve e cila nuk përputhët me kërkesën e FDT "**për zhvillimin e projekteve ideore dhe të hollësishme, të arkitekturës dhe të inxhinierisë**," prandaj si reference nuk e plotëson kërkesën e AK-se dhe si e tille nuk duhet te pranohet sepse nuk është projekt i kompletuar i objektit duke përfshirë fazën e arkitekturës dhe inxhinerise mirëpo sic ceket edhe ne reference është vetëm për fazën e instalimeve çka nuk është ne përputhje me vete kërkesat e FDT-se.

- Shërbime projektuese te instalimeve ne shkollën Kuvendi i Lezhës =- Viti

Ky projekt sipas referencës ka te beje vetëm me fazën e instalimeve e cila nuk përputhet me kërkesën e FDT "**për zhvillimin e projekteve ideore dhe të hollësishme, të arkitekturës dhe të inxhinierisë,"** prandaj si reference nuk e plotëson kërkesën e AK-se dhe si e tille nuk duhet te pranohet sepse nuk është projekt i kompletuar i objektit duke përfshirë fazën e arkitekturës dhe inxhinierisë mirëpo siç ceket edhe ne reference është vetëm për fazën e instalimeve çka nuk është ne përputhje me vete kërkesat e FDT-se.

- Shërbime projektuese për realizimin e projektit ne shkollën Dardania – Prishtine
- Shërbime projektuese për realizimin e projektit ne shkollën Metush Krasniqi – Kamenice

OE ka prezantuar referenca (te bashkangjitura me kete ankese) për zhvillimin e projekteve për renovimin e dy shkollave si institucione publike mirëpo projektet ne fjale siç edhe është

cekur ne reference kane te bëjnë vetëm me renovim te objekteve ekzistuese dhe jo "zhvillimin e tërësishëm te projekteve ideore dhe kryesore te arkitekturës dhe inxhinierisë". Si te tilla këto dy referenca janë ne kundërshtim me kërkesat e FDT-se dhe nuk është dashur te pranohen.

- Realizimi i projektit detal për lagjen San Lorenzo – Kroaci

Referenca e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontrate është ne kundërshtim me kërkesat e FDT-se sepse është i realizuar për kompani private "Mediteran Projekt DOO" e cila është dashur te përjashtohet si reference duke u bazuar ne kërkesën **"Shenim me rendesi "ndërsa përjashton të gjitha tipologjitë e ndërtesave të shërbimeve dhe tregtare [nën-administrim pronësi private]; të gjitha tipologjitë e ndërtesave të banimit shumë-katesh, si të veçanta apo të kombinuara me çfarëdo përmbajtje të tjera funksionale [nën-administrim pronësi private] dhe të gjitha tipologjitë e ndërtesave të industrisë dhe të magazinimit; dhe të gjitha tipologjitë e infrastrukturës së transportit dhe teknike dhe të tjerave të ngjashme [duke mos pasur parasysh formën e administrimit pronësisë], si të veçanta apo të kombinuara me çfarëdo përmbajtje të tjera hapësinore funksionale.**

AK e arsyeton projektin se është në fushën e projektimit, duke injoruar kërkesën e vendosur nga vetë AK që projektet e pronësi private të të gjitha tipologjive përjashtohen, por duke e arsyetuar në kundërshtim me RRPP dhe duke e përfshirë në vlerësim.

Prandaj, si rrjedhojë, referenca nuk është e pranueshme dhe e njëjta është dashur të refuzohet dhe oferta e OE të rekomanduar për kontratë të refuzohet si e papërgjegjshme. Përfundimisht, AK gjatë vlerësimit të ofertave nuk e ka respektuar nenin 1, 7 dhe 59 të LPP-së, duke shpërblyer me kontratë OE-në i cili nuk i plotëson kërkesat e kualifikimit dhe rrjedhimisht duke na diskriminuar neve si OE të përgjegjshëm.

Poashtu sipas kërkesave te UOPP neni 10.1, AK është dashur ta eliminoje ofertën si te papërgjegjshme.

Lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës se përcaktuar	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69

Po ashtu, AK gjatë vlerësimit nuk ka vepruar në përputhje me nenin 25 dhe 40.6 të RRPP 002/2024, prandaj e njëjta duhet të eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit.

Pretendimi 2:

Pretendimi i dytë është i lidhur me kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, që sipas FDT-së është kërkuar:
Kërkesat B- Fuqia profesionale Kërkesa 1 Udhëheqësi kryesor - Komponenti Arkitektura [Menaxheri i kontratës projektit] - Një [1] person profesionist.

Kërkesa 1.1. Arsimi - Fusha e studimeve Arkitekturë Dëshmia e kërkuar dokumentare- Kërkesa 1.1. Arsimi - Diplomë të Nivelit 6 - Sistemi i arsimit të lartë sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve [KKK]- Niveli Bachelor, nga 180 deri në 240 ECTS -Një [1] kopje e origjinalit, e vetëtuar nga noteri. Kërkesa 1.2. Përvoja profesionale - Dhjetë [10] vite përvojë profesionale në hartimin e projekteve të hollësishme të arkitekturës. Dëshmia e kërkuar dokumentare- Kërkesa 1.2.1. Përvoja profesionale - Biografi te hollësishme [Curriculum Vitae]- [Përvoja profesionale përfshinë vetëm periudhën pas arritjes së kualifikimit arsimor të kërkuar] - Një [1] kopje e nënshkruar nga personi i propozuar, dhe e vulosur nga Operatori ekonomik. Dëshmia e kërkuar dokumentare- Kërkesa 1.2.2. Përvoja

profesionale - Referenca te punës te cilat konfirmojnë përvojën paraprake profesionale te paraqitur ne Biografinë e hollësishme - Një [1] kopje e nënshkruar dhe të vulosur nga punëdhënësi- për secilin punëdhënës paraprak.

AK, në përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim, e ka arsyetuar përsëri gabimisht me nenin 65 të LPP-së, i cili ka të bëjë me provueshmërinë e kandidatëve ose tenderuesve, duke vlerësuar se në dokumentet e dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë dhe kërkesave të tenderit nuk ka asnjë mospërputhje.

Ne në kërkesën për rishqyrtim e kemi dëshmuar se OE i rekomanduar për kontrate nuk e ka plotësuar kërkesën sipas FDT-se nga vet fakti se menaxheri i projektit (K.V) nuk posedon dëshmi se i njëjti ka "**Dhjetë [10] vite përvojë profesionale në hartimin e projekteve të hollësishme të arkitekturës".**

Projektet e prezantuara nga OE i rekomanduar për kontratë kanë të bëjnë me projekte në fazën e ndërtimit apo renovimit të objekteve ekzistuese dhe nuk kanë të bëjnë me hartim të projekteve te hollësishme te arkitekturës, sikurse është kërkuar, por që AK e ka injoruar gjatë vlerësimit të dëshmive. Si dëshmi mund te gjeni te gjitha referencat e prezantuara qe nuk kanë te bëjnë fare me atë qe është kërkuar.

I am writing this letter to provide reference for **Mr. Krenar Veseli** , Architect at "Ada Consulting Group shpk" and "SHM Architecture shpk" who was engaged in the capacity of the operator for the renovation works in AER Intervention Package, contracted as per title „Contract for the Construction of Apartment Building Efficiency Retrofits (AER) Prishtina – Lot 1 on 14 June 2022.

Për Operatorin Ekonomik "Ada Consulting Group & Al Trade" Prishtinë, për projektin "Ndërtimi i objektit të Universitetit të Mitrovicës-Faza III" me numër identifikues: 202-15-096-511, Vlera e projektit: Kontrata bazë 7,297,020.80 € gjithashtu Anex-1 339,040.55 € & Anex-2 63,349.00 €.

Gjithsej vlera totale e projektit sipas kontratës dhe Aneks kontratave është 7,699,410.35€.
Gjithashtu konfirmojmë së Menaxher i Projektit për fazën e arkitekturës/Mbrojtjes nga Zjarri/Efiçiencës ka qenë z. Krenar Veseli.

Z. Krenar Veseli Arkitekt i diplomuar ne cilesi te -Arkitektit, ka qene i angazhuar ne kuader te kompanise "Ada Consulting Group sh.p.k & Al-Trade sh.p.k." nga Prishtina, te cilet kanë fituar tenderin publik: "Ndertimi Dekanatit te Fakultetit te Mjekësisë"

Në bazë të kërkesës së kompanisë„ Ada Consulting group" Sh.P.K. nga Prishtina për stafin profesional të angazhuar në kontratën me titull „Renovimi i objekteve të AKSP-së me nr. të prokurimit 214 15 19 521,Departamenti i Prokurimit i AKSP- së lëshon këtë referencë pozitive me të cilën vërteton se:

Me këtë vërtetohet se z. Krenar Veseli, inxhinier i diplomuar i arkitekturesë ka qenë i angazhuar si *Menaxher i Cilësisë dhe Kualitetit* në kuadë te kompanisë "Ada Consulting Group" Sh.P.K në projektin "Ndërtimi i objektit afaristo-banesor- Prishtinë" gjatë periudhes korrik 2012 – dhjetor 2014, në vlerë prej 3,500,000.00 € e financuar nga kompania "Ada Consulting Group" ShPK.

Me këtë vërtetohet që z. Krenar Veseli arkitekt i diplomuar ka qenë i angazhuar si *Arkitekt* në kuadë te kompanisë "Ada Consulting Group" Sh.P.K ne projektin "Renovimi Gjeneral i Aneksit të Emergjencës Ekzistuese në QKUK" me numer te prokurimit 296/11/121/511 në vlerë prej 676,979.24 € e financuar nga Ministria e Shëndetsisë.

Në bazë të kërkesës së z. Krenar Veseli, ne cilësi të Menaxherit të Kontratës dhe menaxher I fazes së arkitekturës, në kuadër të konzorciumit "Control Products & Hidroterm" në projektin: Projekto dhe Nderto (Design and Build):" Ndertimi i Nderteses se MFSK-se"

lëshon këtë :

REFERENCË

Për projektin : "Ndertimi i Ndertese se MFSK-se"
Me numër prokurimi : MAP-202-11-031-511

Me këtë vërtetohet se z. Krenar Veseli, inxhinier i diplomuar i arkitekturesë ka qenë i angazhuar si *Menaxher i Cilësisë dhe Kualitetit* në kuadë te kompanisë "Ada Consulting Group" Sh.P.K në projektin "Ndërtimi i konviktit te ri per AKSP- Vushtrri" gjatë periudhes maj 2013 –gusht 2014, në vlerë prej 932,107.66 € e financuar nga Akademia e Kosovës për Siguri Publike-AKSP.

Për projektin: "Ndërtimi i objektit te akomodimit - Prishtinë"

Me këtë vërtetohet se z. Krenar Veseli, inxhinier i diplomuar i arkitekturesë ka qenë i angazhuar si *Menaxher i Cilësisë dhe Kualitetit* në kuadë te kompanisë "Ada Consulting Group" Sh.P.K në projektin "Ndërtimi i objektit te akomodimit - Prishtinë" gjatë periudhes shtator 2013 – dhjetor 2014, në vlerë prej 845,327.61 € e financuar nga Ministria për Forcën e Sigurisë-FSK.

Për projektin: "Punime ndërtimore në objektin „Poligoni i qitjes" në Vushtrri *(400 m²)*"

Me këtë vërtetohet që z. Krenar Veseli inxhinier i diplomuar i arkitekturës ka qenë i angazhuar si *Menaxher i Projektit* në kuadë te kompanisë "CONTROL PRODUCTS" Sh.P.K ne projektin "Punime ndërtimore në objektin „Poligoni i qitjes" në Vushtrri *(400 m²)*".

Për projektin: "Punimet finale në objektin „Rekonstruimi i shkollës Muze" në Suharekë *(600 m²)*".

Me këtë vërtetohet që z. Krenar Veseli inxhinier i diplomuar i arkitekturës ka qenë i angazhuar si *Menaxher i Projektit* në kuadë te kompanisë "CONTROL PRODUCTS" Sh.P.K ne projektin "Punimet finale në objektin „Rekonstruimi i shkollës Muze" në Suharekë *(600 m²)*".

Me anë të kësaj reference dëshmohet se *ark. Krenar Veseli* inxhinier i diplomuar i arkitekturës ka qenë i angazhuar në kuadër te kompanisë "Control Products" Sh.P.K . si menaxher i punishtes në projektin: " **Ndërtimore I Objektit te Qendrës Tregtare "Ben-af" në Lipjan (34 000 m²)**".

Gjatë gjithë kohës së punimeve *z.Krenar Veseli* inxhinier i diplomuar i arkitekturës, ka kryer me

Me anë të kësaj reference dëshmohet se *ark. Krenar Veseli* inxhinier i diplomuar i arkitekturës ka qenë i angazhuar në kuadër te kompanisë "Control Products" Sh.P.K . si menaxher i punishtes në projektin: "**Ndërtimi i Objektit afaristo-banesor B+P+11 Ben-af në Suharekë (16 500 m²)**".

Gjatë gjithë kohës së punimeve *z.Krenar Veseli* inxhinier i diplomuar i arkitekturës, ka kryer me

Me anë të kësaj reference dëshmohet se *ark. Krenar Veseli* inxhinier i diplomuar i arkitekturës ka qenë i angazhuar në kuadër te kompanisë "Control Products" Sh.P.K . si menaxher i punishtes në projektin: " **Ndërtimi i Objektit afaristo-banesor B+P+7 Ben-af në Prizren** *(24 000 m²)*".

Me anë të kësaj reference dëshmohet se *ark. Krenar Veseli* inxhinier i diplomuar i arkitekturës ka qenë i angazhuar në kuadër te kompanisë "Control Products" Sh.P.K . si menaxher i punishtes në projektin: "**Ndërtimi i Objektit te Qendrës Tregtare "Ben-af" në Malishevë (4000 m²)**".

Gjatë gjithë kohës së punimeve *z.Krenar Veseli* inxhinier i diplomuar i arkitekturës, ka kryer me

Për më tepër, sipas kërkesës së FDT-së: **"Biografi të hollësishme [Curriculum Vitae] – [Përvoja profesionale përfshin vetëm periudhën pas arritjes së kualifikimit arsimor të kërkuar]**
– Një [1] kopje e nënshkruar nga personi i propozuar, dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik."

Në dëshmitë e dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë, CV-ja e dorëzuar nuk është e vulosur nga OE, sikurse kërkohet në FDT, rrjedhimisht duke e bërë të papërgjegjshme dhe të papranueshme ofertën e OE-së së rekomanduar për kontratë.

Përfundimisht, AK gjatë vlerësimit nuk i ka respektuar kërkesat e FDT-së, në bazë të të cilave është kërkuar që stafi i kërkuar të ketë përvojën dhe referencat, të cilat në rastin e OE-së së rekomanduar nuk qëndrojnë, dhe në këtë mënyrë ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së, duke na diskriminuar neve si OE të përgjegjshëm dhe duke e vlerësuar OE-në e rekomanduar si të përgjegjshëm, në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së, nenin 40 të RRPP 002/2024 si dhe nenin 10.1 te UOPP

CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69

Për më tepër, sikurse në pretendimin e parë, AK në mënyrë të gabuar tenton ta arsyetojë vendimin e kundërligjshëm duke iu referuar nenit 65 të LPP-së, i cili nuk ka të bëjë fare me atë që është kërkuar në dosjen e tenderit.

Pretendimi 3:

Pretendimi i tretë është i lidhur me kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, që sipas FDT-së është kërkuar:

Kërkesa 2 Udhëheqësi kryesor- Komponenti Inxhinieria konstruktive - Një [1] person profesionist.

Kërkesa 2.1. Arsimi - Fusha e studimeve Inxhinieri ndërtimore- Drejtimi i konstruksioneve Dëshmia e kërkuar dokumentare- Kërkesa 2.1. Arsimi - Diplomë të Nivelit 6- Sistemi i arsimit të lartë sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve [KKK]- Niveli Bachelor, nga 180 deri në 240 ECTS - Një [1] kopje e origjinalit, e vetëtuar nga noteri. Kërkesa 2.2. Përvoja profesionale - Pesë [5] vite përvojë profesionale ne hartimin e projekteve te hollësishme te inxhinierisë se konstruksioneve. Dëshmia e kërkuar dokumentare- Kërkesa 2.2.1. Përvoja profesionale - Biografi te hollësishme [Curriculum Vitae] - [Përvoja profesionale përfshinë vetëm periudhën pas arritjes së kualifikimit arsimor të kërkuar] - Një [1] kopje e nënshkruar nga personi i propozuar, dhe e vulosur nga Operatori ekonomik. Dëshmia e kërkuar dokumentare- Kërkesa 2.2.2. Përvoja profesionale - Referenca te punës te cilat konfirmojnë përvojën paraprake profesionale te paraqitur ne Biografinë e hollësishme - Një [1] kopje e nënshkruar dhe të vulosur nga punëdhënësi- për secilin punëdhënës paraprak.

OE i rekomanduar për kontrate ka prezantuar inxhinierin Skender Loshi – Konstruktiv. Për inxhinierin ne fjale janë prezantuar referenca te cilat janë për projekte te cilat janë për ndërtim dhe te cilat janë ne cilësinë e menaxherit te punishtes, apo menaxherit te projektit ne projekte te renovimit dhe asnje reference nuk ka te beje me **hartimin e projekteve te hollësishme te inxhinierisë se konstruksioneve**, kështu që nuk janë ne përputhje me kërkesat e FDT-se. Dëshmitë se mospërputhshmërisë se referencave e gjeni me poshtë:

Për Operatorin Ekonomik "Ada Consulting Group & Al Trade" Prishtinë, per projektin **"Ndërtimi i objektit të Universitetit të Mitrovicës-Faza III"**, me numër identifikues: 202-15-096-511, Vlera e projektit: Kontrata bazë 7,297,020.80 € gjithashtu Anex-1 339,040.55 € & Anex-2 63,349.00 €.

Gjithsej vlera totale e projektit sipas kontratës dhe Aneks kontratave është 7,699,410.35€.

Skender Loshi

Për projektin: ***"Punët në rregullimin e parterit me heliodrom, portës hyrëse dhe kompletimi i punëve ndërtimore instalimeve në ndërtesën e MFSK-së"***
Me numër prokurimi: 202-13-088-511

Skender Loshi inxhinier i diplomuar, në cilësi te **Menaxherit te Punishtës**, ka qenë i angazhuar

Për projektin: **"Ndërtimi i objektit afaristo-banesor B+S+P+8+Nk, Arbëri Prishtinë**
Me numër te lejës ndërtimore: 05-351-20540

Me këtë vërtetohet që z. **Skender Loshi inxhinier i diplomuar** i ndërtimtarisë ka qenë i angazhuar si ***Menaxher i Punishtës*** në kuadër te kompanisë "Ada consulting Group"

Për projektin: **"Renovimi Gjeneral i Aneksit të Emergjencës Ekzistuese në QKUK"**
Me numër prokurimi: 206/11/121/511

Me këtë vërtetohet që z. **Skender Loshi** inxhinier i diplomuar ka qenë i angazhuar si ***Menaxher i projektit*** në kuadër te kompanisë "Ada Consulting Group" Sh.P.K ne projektin "Renovimi i Aneksit të Emergjencës Ekzistuese në QKUK" me numër te

Në bazë të kërkesës së z. Skender Loshi
projektin: "Ndertimi I Qendres per Aftesim Profesional ne Gjilan"

lëshon këtë :

REFERENCË

Për projektin : "Ndertimi I Qendres per Aftesim Profesional ne Gjilan"
Me numër prokurimi : 209-11-010-511

Z. Skender Loshi, Inxh.Dipl. Ndert. ne cilesi te Inxhinierit te Projektit ,ka qene i

gjitha obligimet sipas kontratës se nënshkruar me date 07.02.2011, për projektin "Ndërtimi i objekti të kuzhinës në Pomozotin", me numër të prokurimit 21700/10/137/511 , në vlere prej 908,852.21 €.

Gjate kohës se realizimit të punimeve të këtij projekti , kontraktuesi ka pasur të angazhuar, ing diplomuar i ark. Shpëtim Muslin , si projekt menaxher të kontratës dhe ing. i diplomuar i ndërtimtarisë Skënder Loshi, në cilësi të inxhinierit

Me këtë vërtetohet që z. Skender Loshi inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë eshte i angazhuar si Menaxher i Punishtës ne kuadër te kompanisë "Ada Consulting Group" Sh.P.K Sh.P.K ne projektin "Ndërtimi i ndërtesës së MFSK-së" me numer te prokurimit 12300-11-031-511 në vlerë prej 1,518,516.00 € e financuar nga Ministria e Administrates Publike.

Gjatë gjithë kohës së punimeve z. Skender Loshi, inxhinier i diplomuar, ka kryer me

Me këtë vërtetohet që z. Skender Loshi inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë eshte i angazhuar si *Menaxher i Punishtes* në kuadë te kompanisë "Ada consulting Group" Sh.P.K ne projektin "Ndertimi i Universitetit te Mitrovicës faza II" me numër identifikues: 202-14-056-511, në vlerë prej 2,087,539.62 € investim i Ministrisë se Administratës Publike.

Me këtë vërtetohet që z. Skender Loshi inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ka qenë i angazhuar si *Menaxher i Punishtës* në kuadë te kompanisë "Ada consulting Group" Sh.P.K ne projektin "Punimi i I objektit ndaristo-banesor, Drenas"me numër te lejës ndërtimore: 08-351-35453në vlerë prej 110,000.00 € investim i kompanisë "Elkom" Sh.P.K.

Për projektin: "Ndertimi Dekanatit te Fakultetit te Mjekësisë"
Me numër prokurimi: 90400/14-15/070-019/511

Z. Skender Loshi Inxhinier diplomuar I ndertimtarisë ne cilesi te -Menaxherit te Punishtes, ka qene i angazhuar ne kuader te kompanise "Ada Consulting Group sh.p.k &

- Stafi profesional i lartpërmendur ka qenë i angazhuar në kuadër të Kompanisë "Ada Consulting Group" sh.p.k nga Prishtina, për realizimin e punimeve të kontratës: "Renovimi i Objektit në Hajvali për DPK-në" me nr të prokurimit: 214329/012/005/511, në vlerë prej 373,233.35 € e datës:13.09.2012.

Në bazë të kërkesës së kompanisë,, Ada Consulting group" Sh.P.K. nga Prishtina për stafin profesional të angazhuar në kontratën me titull ,,Renovimi i objekteve të AKSP-së me nr. të prokurimit 214 15 19 521,Departamenti i Prokurimit i AKSP- së lëshon këtë referencë pozitive me të cilën vërteton se:

I am writing this letter to provide reference for **Mr. Skender Loshaj,** Site Engineer of "Ada Consulting Group shpk" and "SHM Architecture shpk" who was engaged in the capacity of the operator for the renovation works in AER Intervention Package, contracted as per title „Contract for the Construction of Apartment Building Efficiency Retrofits (AER) Prishtina – Lot 1 on 14 April2022.

Si reference OE i rekomanduar për kontrate ka prezantuar edhe referencën nga Mediteran Projekt DOO e cila është për projekt dizajn për lagjen "San Lorenzo" ne Kroaci por e cila nuk mjafton sepse kërkesa e FDT-se është "**Referenca**" prandaj sikurse është kërkuar i njëjti duhet te posedoj se paku dy referenca ne mënyrë qe te plotësojë kërkesat e FDT-se. Prandaj si e tille nuk është dashur te pranohet si i përgjegjshëm.

Në dështmitë e dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë, edhe ne këtë CV-ja e dorëzuar nuk është e e vulosur nga OE, sikurse kërkohet në FDT, rrjedhimisht duke e bërë të papërgjegjshme dhe të papranueshme ofertën e OE-së së rekomanduar për kontratë.

Njëjtë si ne pretendimin e mëparshëm AK edhe ne këtë pike ka vepruar ne kundërshtim me nenin 7, 52 dhe 59, nenin 40.6 te RRPP si dhe nenin 10.1 te UOPP

CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69

duke na diskriminuar neve si OE te vetmin te përgjegjshëm.

Pretendimi 4:

Pretendimi i katërt është i lidhur me kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, që sipas FDT-së është kërkuar:

Kërkesa 4 Udhëheqësi kryesor- Komponenti Inxhinieria elektrike elektro-teknike - Një [1] person profesionist.

Kërkesa 4.1. Arsimi - Fusha e studimeve Inxhinieria elektrike- Drejtimi i elektro-energjetikës Dështmia e kërkuar dokumentare- Kërkesa 4.1. Arsimi - Diplomë të Nivelit 6- Sistemi i arsimit të lartë sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve [KKK]- Niveli Bachelor, nga 180 deri në 240 ECTS - Një [1] kopje e origjinalit, e vetëtuar nga noteri. Kërkesa 4.2. Përvoja profesionale - Pesë [5] vite përvojë profesionale ne hartimin e projekteve te hollësishme te inxhinierisë elektrike elektro-teknike. Dështmia e kërkuar dokumentare- Kërkesa 4.2.1. Përvoja profesionale -Biografi te hollësishme [Curriculum Vitae] - [Përvoja profesionale përfshinë vetëm periudhën pas arritjes së kualifikimit arsimor të kërkuar] - Një [1] kopje e nënshkruar nga personi i propozuar, dhe e vulosur nga Operatori ekonomik. Dështmia e kërkuar dokumentare- Kërkesa 4.2.2. Përvoja profesionale - Referenca te punës te cilat konfirmojnë përvojën paraprake profesionale te paraqitur ne Biografinë e hollësishme

OE i rekomanduar për kontrate ka prezantuar inxhinierin Agim Kastrati – Inxhinier i Elektroteknikes.

Për inxhinierin ne fjale janë prezantuar referenca te cilat janë për projekte te cilat janë për ndërtim dhe te cilat janë ne cilësinë e menaxherit te punishtes, apo menaxherit te projektit ne projekte te renovimit dhe te cilat nuk janë ne përputhje me kërkesat e FDT-se.

AK ne përgjigjen ne kërkesën për rishqyrtim e ka dhënë te njëjtin arsyetim sikurse ne pretendimet 2 dhe 3 duke ju referuar ne mënyrë te gabuar neneve mbi te cilat edhe e ka marrë vendimin.

Si dëshmi po ju paraqesim referencat e vlerësuara nga AK te cilat nuk janë ne përputhje me kërkesat e FDT-se.

Për Operatorin Ekonomik "Ada Consulting Group & Al Trade" Prishtinë, për projektin "Ndërtimi i objektit të Universitetit të Mitrovicës-Faza III" me numër identifikues: 202-15-096-511, Vlera e projektit: Kontrata bazë 7,297,020.80 € gjithashtu Anex-1 339,040.55 € & Anex-2 63,349.00 €.

Gjithsej vlera totale e projektit sipas kontratës dhe Aneks kontratave është 7,699,410.35€.
Gjithashtu konfirmojmë se z. Agim Kastrati ka qenë i angazhuar si inxhinier i elektrikës.

Ne bazë te kërkesës së z. Agim Kastrati , ne cilesi te Inxhinierit te Projektit, ne projektin "Ndërtimi i Qendrës per Aftesim Profesional në Mitrovicë"

lëshon këtë:

REFERENCË

Për projektin : "Ndërtimi i Qendrës per Aftesim Profesional në Mitrovicë"
Me numër prokurimi: 209-12-009-511

Z. Agim Kastrati Ing.i diplomuar i Elektros ne cilesi te Inxhinierit te Projektit,ka qene

Faton ABAZAJ-Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë- drejtim mbro
Agim KASTRATI-Inxhinier i diplomuar i Elektros
Muhamet PLLANA-Inxhinier i diplomuar i Makinerisë

NGA: Agim FEJZULLAHI,
Drejtor i Departamentit i Prokurimit - MPB

R E F E R E N C Ë

Ne bazë të kërkesës së kompanisë ACG nga Prishtina, për stafin profesional të angazhuar në kontratën "Renovimi i Objektit në Hajvali për IPK-në" me nr prokurimi: 214329-12-005-511, Departamenti i Prokurimit i Ministrisë së Punëve të Brendshme, lëshon këtë referencë, me të cilën vërteton se: .

Agim Kastrati - Inxhinier i Diplomuar i Elektroteknikës
Përparim Haxhiu – Bacheleor i Arkitekturës

Ne bazë të kërkesës së kompanisë,, Ada Consulting group" Sh.P.K. nga Prishtina për stafin profesional të angazhuar ne kontratën me titull ,,Renovimi i objekteve të AKSP-së me nr. të prokurimit 214 16 19 521,Departamenti i Prokurimit i AKSP- së lëshon këtë referencë pozitive me të cilën vërteton se:

Për projektin: "Ndërtimi i ndërtesës së MFSK-së"
Me numër prokurimi: 12300-11-031-511

Me këtë vërtetohet që z. Agim Kastrati inxhinier i diplomuar i elektrikës ka qenë i angazhuar si Inxhinier i Elektrikës ne kuadër te kompanisë "Ada Consulting Group" Sh.P.K Sh.P.K ne projektin "Ndërtimi i ndërtesës së MFSK-së" me numer te prokurimit 12300-11-031-511 në vlerë prej 1,518,516.00 € e financuar nga Ministria e Administratës Publike.

Gjatë gjithë kohës së punimeve z. Agim Kastrati, inxhinier i diplomuar, ka kryer me

Si reference OE i rekomanduar për kontrate ka prezantuar edhe referencën nga Mediteran Projekt DOO e cila është për projekt dizajn për lagjen "San Lorenzo" ne Kroaci por e cila nuk mjafton sepse kërkesa e FDT-se është "**Referenca** " prandaj sikurse është kërkuar i njëjti duhet te posedoj se paku dy referenca ne mënyre qe te plotësoje kërkesat e FDT-se. Prandaj si e tille nuk është dashur te pranohet si i përgjegjshëm.

Po ashtu ne dëshmitë e dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë, edhe ne këtë CV-ja e dorëzuar nuk është e e vulosur nga OE, sikurse kërkohet në FDT, rrjedhimisht duke e bërë të papërgjegjshme dhe të papranueshme ofertën e OE-së së rekomanduar për kontratë.

Njëjtë si ne pretendimin e mëparshëm AK edhe ne këtë pike ka vepruar ne kundërshtim me nenin 7, 52 dhe 59, nenin 40.6 te RRPP si dhe nenin 10.1 te UOPP

CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69

duke na diskriminuar neve si OE te vetmin te përgjegjshëm.

Pretendimi 5:

Pretendimi i pestë është i lidhur me kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, që sipas FDT-së është kërkuar:

Kërkesa 5 Udhëheqësi kryesor- Komponenti Inxhinieria mekanike makinerike - Një [1] person profesionist.

Kërkesa 5.1. Arsimi -Fusha e studimeve Inxhinieria mekanike makinerike- Drejtimi i termo-energjetikës Dëshmia e kërkuar dokumentare- Kërkesa 5.1. Arsimi - Diplomë të Nivelit 6- Sistemi i arsimit të lartë sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve [KKK]- Niveli Bachelor, nga 180 deri në 240 ECTS - Një [1] kopje e origjinalit, e vetëtuar nga noteri. Kërkesa 5.2. Përvoja profesionale - Pesë [5] vite përvojë profesionale ne hartimin e projekteve te hollësishme te inxhinierisë mekanike makinerike. Dëshmia e kërkuar dokumentare- Kërkesa 5.2.1. Përvoja profesionale - Biografi te hollësishme [Curriculum Vitae] - [Përvoja profesionale përfshinë vetëm periudhën pas arritjes së kualifikimit arsimor të kërkuar] - Një [1] kopje e nënshkruar nga personi i propozuar, dhe e vulosur nga Operatori ekonomik. Dëshmia e kërkuar dokumentare- Kërkesa 5.2.2. Përvoja profesionale - Referenca te punës te cilat konfirmojnë përvojën paraprake profesionale te paraqitur ne Biografinë e hollësishme.

OE i rekomanduar për kontrate ka paraqitur inxhinierin Blerim Koca. Inxhinieri ne fjale përveç biografisë nuk ka paraqitur asnjë reference me te cilën dëshmon se i njëjti e plotëson kërkesën e FDT- se si është kërkuar "**Pesë [5] vite përvojë profesionale ne hartimin e projekteve te hollësishme te inxhinierisë mekanike makinerike. Referenca te punës te cilat konfirmojnë përvojën paraprake profesionale te paraqitur ne Biografinë e hollësishme".**

Ne përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim nga AK sikurse ne pretendimet e mëparshme i është referuar nenit 65 te LPP-se qe nuk ka te beje me atë qe ne pretendojmë këtu dhe nuk re ka shqyrtuar fare pretendimin tone se inxhinieri nuk e ka prezantuar asnjë reference por vetëm ju ka referuar se i plotëson kërkesat pa e dëshmuar te kundërtën e asaj qe ne pretendojmë.

Ne dëshmitë qe ne i kemi marre nga AK i njëjti nuk ka te paraqitur asnjë reference me te cilën dëshmon se e plotëson këtë kërkesë. AK gjatë vlerësimit e ka pranuar te njëjtin pa e plotësuar kërkesën dhe si te tille gjate vlerësimit ka bere shkelje te nenit 7 dhe 59 te LPP-se duke mos na trajtuar ne mënyrë te barabarte dhe duke mos e eliminuar OE për shkak te mos përmbushjes se kritereve kualifikuese.

Njëjtë si ne pretendimin e mëparshëm AK edhe ne këtë pike ka vepruar ne kundërshtim me nenin 7, 52 dhe 59 duke na eliminuar neve si OE te përgjegjshëm dhe duke rekomanduar për kontrate OE i cili nuk i plotëson kërkesat e FDT-se.

Pretendimi 6:

Pretendimi ka te bëjë me raportin e vlerësimit te bere nga komisioni i vlerësimit te caktuar nga AK:

Pasi kemi kërkuar qasjen në dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë dhe dokumentet tjera pjesë të këtij aktiviteti të prokurimit, ne kemi analizuar me kujdes edhe raportin e vlerësimit të komisionit, në të cilin ne kemi hasur në lëshime të mëdha nga AK, duke pasur parasysh se në kërkesën për projekte në vlerë deri në 150 mijë euro të prezantuara nga OE i rekomanduar për kontratë, nuk është vlerësuar fare nga komisioni i vlerësimit se cilat projekte janë përfshirë si të pranueshme, me të cilat OE i rekomanduar për kontratë e ka plotësuar këtë kriter, por vetëm e kanë përshkruar "në pajtim".

Ne si OE pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, sikurse e kemi përshkruar edhe në pretendimin e parë, nuk kemi gjetur asnjë projekt me të cilin OE i rekomanduar për kontratë do të plotësonte kërkesat e FDT-së, përkundër kësaj AK gjatë vlerësimit nuk e ka analizuar asnjë projekt apo nuk ka dhënë asnjë arsyetim se si e plotëson këtë kërkesë OE i rekomanduar për kontratë.

Për më tepër, AK nuk e ka arsyetuar se si mund të vlerësohen projektet të cilat nuk i plotësojnë kërkesat e FDT-së si të pranueshme për AK-në. Njëjtë është vepruar edhe me stafin profesional, të cilin AK nuk e ka trajtuar gjatë vlerësimit të ofertave, por vetëm e ka përshkruar shabllonin e dhënë nga sistemi i e-prokurimit, në këtë mënyrë duke mos dëshmuar në realitet se si i plotëson kërkesat e FDT-së OE i rekomanduar për kontratë.

Ne në pretendimet tona i kemi paraqitur të gjitha dëshmitë që stafi nuk është vlerësuar në përputhje me kërkesat e FDT-së, por që AK nuk është përgjigjur në pretendime, por vetëm ju ka referuar nenit 26 të LPP-së, të cilat s'kanë të bëjnë fare me nenet e LPP-së që ne pretendojmë se janë shkelur.

Si përfundim, ne vlerësojmë se AK gjatë vlerësimit nuk e ka argumentuar asnjë kriter në bazë të të cilit ka vlerësuar se OE i rekomanduar për kontratë i plotëson kërkesat e FDT-së, duke dhënë vlerësime të përgjithshme, në këtë mënyrë duke mos i respektuar as kriteret të cilat vet i ka vendosur në dosje të tenderit dhe duke krijuar paqartësi, dhe në këtë mënyrë duke bërë shkelje të nenit 40.5, 40.6 dhe duke mos e argumentuar asnjë vlerësim në bazë të nenit 40.7 se si është në pajtueshmëri oferta e OE të rekomanduar për kontratë. Prandaj, vlerësojmë se neve si OE jemi diskriminuar, duke u favorizuar një OE i cili nuk i përmbush kërkesat kryesore të FDT-së dhe në këtë mënyrë duke na shkaktuar dëm. Si rrjedhojë, kërkojmë që i njëjti të rivlerësohet në përputhje me kriteret e përcaktuara në FDT dhe të shpallet i papërgjegjshëm.

Pretendimi 7:

Kërkesa 1.2. - Operatori ekonomik Grupi i operatoreve ekonomik, duhet të ofrojë dëshmi të gjendjes ekonomike dhe kapacitetit financiar për të përmbushur kërkesat e lëndës së kësaj procedure. Për këtë qëllim, Operatori ekonomik Grupi i operatoreve ekonomik, duhet të dëshmojë se gjatë tre [3] viteve fiskale të shkuara- 2021, 2022 dhe 2023, ka siguruar të ardhura minimale vjetore bruto, nga kontratat që kanë të bëjnë me shërbimet për zhvillimin e projekteve ideore dhe të hollësishme, të arkitekturës dhe të inxhinierisë, për zhvillimin e ndërtesave publike shoqërore, në vlerë mbi 200,000.00 € [dy-zero-zero, zero-zero-zero. zero-zero euro].

Dëshmia e kërkuar dokumentare- Kërkesa 1.2. - Raportin ose raportet përkatëse nga një ose më shumë banka; - Kopjet e certifikuara të një ose më shumë bilanceve të gjendjes ose ekstrakteve nga bilancet e gjendjes [Në rast të Grupit të operatoreve

ekonomik, dëshmia duhet të dorëzohet ne veçanti për secilin Operator ekonomik] - Një [1] kopje e origjinalit, e vërtetuar nga noteri.

Nga qasja ne dokumentet e dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontrate te njëjtit nuk e plotësojnë kërkesën e FDT-se sepse ne dokumente nuk janë dorëzuar "**Kopjet e certifikuara të një ose më shumë bilanceve të gjendjes ose ekstrakteve nga bilancet e gjendjes"** te cilat është dashur te dorëzohen dhe te jene te noterizuara sipas kërkesës se FDT-se.

Autoriteti Kontraktues, në përgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim, në njërën anë deklaron se dokumentacioni i Operatorit Ekonomik të rekomanduar për kontratë është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në FDT, ndërsa në anën tjetër pranon se dokumentet përkatëse nuk janë dorëzuar në formën e kërkuar, duke arsyetuar mungesën e noterizimit me faktin se dokumentet janë "të qarta dhe autentike".

Një qasje e tillë përbën shkelje të hapur të Ligjit për Prokurimin Publik dhe të kritereve të vendosura në dosjen e tenderit nga vetë Autoriteti Kontraktues. Për më tepër, kjo përbën një trajtim të pabarabartë dhe diskriminues ndaj nesh si Operator Ekonomik që ka respektuar të gjitha kërkesat e përcaktuara. Shtrohet pyetja thelbësore: si është e mundur që një kriter i detyrueshëm për të gjithë operatorët ekonomikë të konsiderohet i panevojshëm vetëm në rastin e një OE-je të caktuar, duke e favorizuar atë në mënyrë të padrejtë dhe në kundërshtim me parimet e barazisë në trajtim?

Sipas FDT OE i rekomanduar për kontrate nuk i ka dorëzuar kopjet e certifikuara te bilancit te gjendjes te noterizuar derisa AK gjate vlerësimit prape e ka vlerësuar si te përgjegjshëm duke mos e arsyetuar se si mund te jete i përgjegjshëm një oferte nëse nuk i dorëzon dokumentet sipas kërkesave te FDT-se. Për me tepër edhe ne kërkesën për rishqyrtim e përsërit shkeljen e njëjtë me vetëdije te plote.

Ne këtë mënyrë AK gjate vlerësimit ka bere shkelje te RRPP 002/2024 nenit 40 si dhe nenit 7 dhe 59 te LPP-se dhe se i njëjti duhet te kthehet ne rivlerësim dhe te eliminohet ne përputhje me kërkesat qe janë obligative e te cilat nuk janë plotësuar nga OE i rekomanduar për kontrate.

Pretendimi 8:

Pretendimi jone ne këtë pike lidhet me Formulari i Konkursit te Projektimit pjesa III oferta financiare.

Sipas kërkesave te dosjes se tenderit projekti duhet te përfundohet si me poshtë:

Shënim me rendësi:
Afati kohor për zbatimin e kontratës është njëqind-e-njëzet (120) ditë;

OE i rekomanduar për kontrate ne formularin e tenderit ka dorëzuar tekstin si ne vijim:

1. Ne, të nënshkruarit, ofrojmë që të dorëzojmë projektimin e detajuar inxhinierik për konkursin e projektimit të lartë cekur në pajtim me Dosjen e juaj të Konkursit të Projektimit Nr. **207-24-9503-2-2-3** dhe Koncept Propozimin.

2. Propozimi jonë Financiar për projektimin e radhës (projektimin e detajuar inxhinierik) është në shumë prej: Çmimi total i tenderit është:

Nentedhjet e gjashte mije, 96,000.00 euro

3. [Nëse koncept projekti jonë fiton për fazën e radhës së projektimit, ne marrim përsipër të bëjmë nënshkrim të kontratës dhe të dorëzojmë "projektimin e detajuar inxhinierik" brenda [njëqind-e-njëzet (120) ditë, përfshirë tridhjetë (30) ditë shtesë pas periudhës në fjalë]:] pas nënshkrimit të kontratës.

4. Operatori Ekonomik [*SHM ARCHITECTURE*] kanë këtë nacionalitet: **SHQIPTAR**

Përkundër faktit se kërkesa e FDT-se ka qene qe kontrata te realizohet brenda 120 ditëve OE i rekomanduar për kontrate ka dhënë afat te përfundimit te kontratës prej 150 ditëve. Kjo është ne kundërshtim me kërkesat e tenderit si dhe paraqet shkelje te nenit 10.1 te UOPP ne baze te te cilit oferta e OE është dashur te refuzohet për mos përmbushje te kushtit administrativ.

Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ

Duke u bazuar në dëshmitë mbi shkeljet ne pikat ankimore të lartpërmendura kërkojmë nga **OSHP** që të marr:

VENDIM

ANULOHET - Njoftimi mbi vendimin e AK-se lidhur me aktivitetin e prokurimit me nr Prokurimit: **207-24-9503-2-2-3** dhe titull: **Zhvillimi i projektit ideor dhe të hollësishëm [zbatues kryesor], të arkitekturës dhe të inxhinierisë, për ndërtimin e Stadiumit të ri në Rahovec, në përputhje me Kategorinë II plus të rregulloreve dhe udhëzimeve teknike për infrastrukturë të stadiumeve, të miratuara nga UEFA. RITENDERIM**, te inicuar nga AK
MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK

APROVOHET:

Ankesa si e Bazuar dhe lënda: KTHEHET NE RI VLERESIM DHE VLERESIMI TE BEHET NE PERPUTHJE ME RRPP 002/2024 DHE LPP.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Demet e shkaktuara janë shpenzimet ne përgatitjen e ofertës, dëme ne reputacion dhe fitimi i humbur.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*